



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORIA E NAVIGIMIT AJROR

№ 2489 prot.

Tiranë, më 16.10.2024

VENDIM

Nr. 110, datë 16.10.2024

PËR

PËR PRANIMIN DHE PUBLIKIMIN E MJETEVE TË PËRPUTHSHMËRISË
(AMC) DHE MATERIALEVE UDHËZUESE (GM) TË EASA PËR PËRDORIM PËR
ZBATIMIN E URDRIT TË MINISTRIT TË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË NR. 42, DATË 27.03.2023, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të Nenit 14, pika (ë), të Ligjit Nr. 53/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”, për zbatimin e Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturrës dhe Energjisë Nr. 42, datë 27.3.2023 për miratimin e rregullores “Mbi përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e AMC dhe GM të EASA “*AMC/GM to IRS Standardised European Rules of the Air (SERA) Issue 1, Amendment 6, date 1/12/2022*” për zbatimin e Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) No 923/2012 të datës 26 Shtator 2012 “Për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikqyrjen e tyre” të ndryshuar.
2. Për të siguruar përputhshmërinë me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturrës dhe Energjisë Nr. 42, datë 27.3.2023 do të përdoren AMC, GM të EASA në gjuhën angleze, të pranuar me këtë vendim dhe të publikuara nga EASA në adresën e internetit: <https://www.easa.europa.eu/en/document-library/acceptable-means-of-compliance-and-guidance-materials/amc-and-gm-rules-air-issue-2>
3. Ngarkohet Drejtoria e Navigimit Ajror, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria e Navigimit Ajror dhe Drejtoria e Sigurisë në Fluturim, të marrin masa për njoftimin apo publikimin për Ofruesin e Shërbimeve të Lundrimit Ajror dhe operatorët ajrorë, të pranimit të AMC dhe GM të mësipërme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Aviacionit Civil.

DREJTOR EKZEKUTIV

Maksim Et'hemaj

